



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANË

NR. 1683 Regj.Themeltar

NR.1631 VENDIMI

V E N D I M

NE EMER TE REPUBLIKES

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane, e perbere prej:

GJYQTAR: MARTIN DEDA

asistuar nga sekretarja gjyqesore **Blerina Merdani**, me pjesmarrjen e prokurorit **Ervin Karanxha** mori ne shqyrtim ne séance gjyqesore publike, me date 30.06.2014 çeshtjen penale me Nr. 2161 Regj.Themeltar ne ngarkim te:

I PANDEHUR:

A K, , perfaqesuar nga av.Spiro Kasa.

AKUZUAR:

Per vepren penale te “Pervetesim i parave ose mallerave qe rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale” parashikuar nga neni 287/b K.Penal.

Gjykata, pasi administroi provat, degjoi Prokurorin e çeshtjes Ervin Karanxha i cili ne diskutimin perfundimtar i kerkoj gjykates:

1. *Deklarimin fajtor të të pandehurit **A K** per kryerjen e veprës penale “Pervetesimi i parave ose mallrave qe rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale”, parashikuar nga neni 287/b i Kodit Penal dhe denimin e tij me 1 vit e 9 muaj burgim.*
2. *I sugjeroj Gjykates aplikimin e nenit 406 te Kodit te Procedures Penale.*
3. *Ne baze te nenit 190 te Kodit te Procedures Penale:*
4. *Kalimin ne favor te shtetit shqiptar te sendeve te sekuestrura si me poshte:*

5. *Te procesverbalit te sekuestrimit te proves materiale te dates 09.10.2013 me numer rendor 1 ne 27 sekuestruar shtetasit A K, pasi jane trashgimi kulturore, dhe si te tilla i perkasin shtetit shqiptar.*
6. *Shpenzimet procedurale ne shumen perkatese t'i lihen ne ngarkim te pandehurit.*

Degjoi av.Spiro Kasa i cili ne konkluzionet perfundimtare i kerkoi gjykates;

Pafajsi per te pandehurin A K.

Gjykata, ne perfundim te gjykimit

VEREN:

Ne Gjykatën e Rrethit Gjyqsore Tirane ka ardhur per gjykim ceshtja penale.

Nga shqyrtimi gjyqsore i bere rezulton se:

I pandehuri A K eshte banor i qytetit te Tiranes,

Ne séancen gjyqsore te dates 28.05.2014 av.Spiro Kasa dhe i pandehuri A K paraqiten kerkese me goje para gjykates, ku kerkuan "Gjykim te shkurtuar" ne baze te nenit 403 te K.Pr.Penale.

Gjykata pasi degjoi mendimin e prokurorit i cili ishte dakort per procedim me gjykim te shkurtuar, dhe se ceshtja mund te zgjidhet ne gjendjen qe jane aktet, vendosi te pranoj kerkesen e te pandehurit dhe te procedoj me gjykim te shkurtuar.

Nga gjykata u cmua per te proceduar me gjykim te shkurtuar pasi gjendja ne te cilen ndodhen aktet eshte e tille qe lejon zhvillimin e nje gjykimi te tille. Po ky lloj gjykimi shkurton procedurat, rrit shpejtesine dhe efikasitetin e gjykimit. Pavec perfitimit prej uljes se 1/3 se denimit per te pandehurin, logjika legjislative (Ratione Legis) ku ka sanksionuar kete lloj gjykimi ka pasur parasysh edhe ekonomin gjyqsore duke bere zgjidhjen sa me efektive.

Nga ana e te pandehurit u pranua te procedohet me gjykim te shkurtuar sepse ceshtja mund te zgjidhet ne gjendjen qe jane aktet e grumbulluara gjate hetimeve paraprake.

Nisur nga fryma qe pershkron kapitullin e gjykimeve te posacme dhe pikerisht dispozitat procedurale per gjykimin e shkurtuar, gjykata konkludon se pohimi i fajse nga i pandehuri nuk eshte kusht per te proceduar me gjykim te shkurtuar. Kjo per faktin se te pandehurit kur kerkohet procedim me gjykim te shkurtuar, dhe kur kjo kerkese e tij pranohet nga gjykata, i ulet denimi per shkak te marreveshjes dhe jo per faktin se ka pranuar apo jo fajse. Qendrimi i te

pandehurit ne lidhje me fajesin nuk e pengon gjykatën te pranoje gjykimin e shkurtuar pasi disponimi ne lidhje me fajesin ose jo eshte atribut i gjykates.

Pra duke u pranuar nga ana e gjykates te procedohet me gjykim te shkurtuar nisur nga gjendja ne te cilen ndodhen aktet cmohet se nuk cenohet drejtesia dhe interesat e ligjshme te te pandehurit.

Gjykata pasi studjoi materialet e fashikullit me numer . te hetimit te paraqitura per gjykim bazuar ne nenin 69 te Kodit te Procedures Penale, cmojne se ceshtja eshte ne juridiksjonin e saj dhe gjykimi i kesaj ceshtje penale duhet te realizohet perpara kesaj gjykate.

Po keshtu kjo ceshtje ne baze te neni 68 te Kodit te Procedures Penale eshte ne kopetencen lendore te kesaj gjykate, pasi vepra penale, parashikuar nga neni 287/b, te Kodit Penal, per te cilat eshte proceduar i pandehuri gjykohet me trup gjykues te perbere nga nje gjyqtare.

Persa i perket kopetences toksore, ajo percaktohet shprehimisht ne menyre ekspresive ne nenin 76 te Kodit te Procedures Penale ku citohet se: Kopetenca toksore percaktohet, me rradhe nga vendi ku eshte kryer ose tentohet te kryhet vepra penale, ose vendi ku ka ndodhur pasoja.Persa me siper, perderisa vepra penale ka ndodhur ne Tirane, kompetente per nga territori eshte kjo gjykate.

Nga shqyrtimi i akteve te ndodhura ne fashikullin e hetimit me nr. te viti 2013 ne ngarkim te te pandehurit A K rezulton se:

Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Tirane ka regjistruar procedimin penal me nr. . per vepren penale te “Pervetesim i parave ose mallerave qe rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale” parashikuar nga neni 287/b K.Penal ne ngarkim te te pandehurit A K.

Ne . nga ana e Seksionit Kunder Trafikeve te Paligjshme ne Drejtorine e Policise se Qarkut Tirane eshte arrestuar i pandehuri A K pasi ne objektin qe ky i pandehur punonte jane gjetur nje sasi sendesh dhe objekte te cilat dyshohet se jane te vjedhura. Keto sende jane sekuestruar me cilesine e proves materiale. Nga procesverbali i dates . rezulton se ne vendin e punes te te pandehurit A K jane sekuestruar shume objekte qe sipas procesverbalit te sekuestrimit te proves materiale kane numrin rendor nga 1 ne 27.

Eshte pyetur i pandehuri A K i cili sqaron se eshte zdrukthtar prej shume kohesh.Ai eshte subjekt i regjistruar dhe i licensuar ne kete fushe. Puna e tij konsiston ne restaurimin e mobiljeve te vjetra, mbledhjen e sendeve te vjetra etj.Ai ka grumbulluar sende te vjetra ne kohe te ndryshme pasi i restauronte ato. Ai ka blere sende nga persona te ndryshem si pjese druri duke vleresuar punen artistike. Ka grumbulluar sende te ndryshme nga persona e ndryshem. Vete i pandehuri A K shpjegon se nuk eshte marre me asnje aktivitet te paligjshem dhe sendet qe i jane gjetur ne vendin ku ky i pandehur punon i ka blere pasi merret

me pune artistike. Ky i pandehur thote se tek kati i dyte i magazines se tij gjenden shume objekte te vjetra te cilat i ka blere dhe qe jane te koheve te ndryshme.

I pandehuri A K ka qene zdrukthtar, ai ka marre sende te vjetra nga persona te ndryshem. Nje pjese e ketyre sendeve (4 pjese te vogla ikonostasesh) kane dale se kane qene te vjedhura. Ky i pandehur eshte zdrukthtar ka edhe punishte druri dhe ben mobilje, ne keto kushte ne rastin konkret jemi para vepres penale te parashikuar nga neni 287/b te Kodit Penal. Sendet e marra prej tij jane te rralla dhe te kufizuara ne qarkullimin civil. Duke pasur parasysh faktin se ky i pandehur ushtron aktivitetet dhe ka njohuri te posacme (pasi eshte zdrukthtar) atehere ai ka pasur dijeni dhe sipas rrethanave duhej te kishte dijeni, se sendet e marra prej tij kane qene te vjedhura, sic dhe ka rezultuar ne rastin konkret.

Nga verifikimi sipas tabelës fotografike tek A K vepra arti te cilat rezultojne te vjedhura sipas aktit te ekspertimit jane : numrat : **397**.Fragment ikonostasi i gdhendur, dru, anonim, 17.4 x 88 x 4.2 cm, shek. XIX. Ky fragment i takon ikonostasit te Kishes se Shen Merise, Bishtqethen, Lushnje, Komuna Kolonje. **410**.Fragment kollone ndarese e gdhendur, dru, anonim, 40.6 x 10.1 x 5 cm, shek. XIX. Ky fragment i takon ikonostasit te Kishes se Shen Merise, Bishtqethen, Lushnje, Komuna Kolonje. **411**.Fragment kollone ndarese e gdhendur, dru, anonim, 36.4 x 5 x 3.5 cm, shek. XVIII-XIX. Kjo kolone baltakini eshte shkeputur nga Kisha e Shen Thanasit, Karavasta Lushnje. **415**.Fragment i pjeses se siperme te ikonave te vogla te ikonostasit, dru, anonim, 126 x 15 x 5 cm, shek. XIX. Ky fragment i takon ikonostasit te Kishes se Shen Merise, Bishtqethen, Lushnje, Komuna Kolonje.

Keto fakte kane dale nga akti i ekspertimit i dates . i cili eshte dorezuar nga Kryetari i Grupit te Eksperteve Y D ne Prokurorine e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Vete i pandehuri e pranon faktin se i ka pasur keto sende ne vendin e punes se tij.

I pyetur ne hetimet paraprake dhe ne gjykate i pandehuri A K nuk e ka pranuar akuzen por ka kerkuar pafajsi.

Ne séance gjyqesore u moren ne shqyrtim dhe u administruan provat shkresore te meposhteme;

Fajesia e te pandehurit A K provohet plotesisht me deklarimet e tij ne prokurori dhe ne gjykate si dhe me provat shkresore:

Për sa sipër, organi akuzes kerkoi deklarimin fajtor te te pandehurit A K ,e në caktimin e llojin dhe masën e dënimit ndaj të pandehurit, gjykata duhet të mbajë parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajësisë, si

dhe rrethanat rënduese dhe lehtësuese, rrethana këto që mendojmë se do t'i shërbejnë qëllimit të dënimit .

Të jetë në përshtatshmëri, jo vetëm me rrezikshmërinë e veprës dhe të autoreve të saj, por dhe që të jetë e tillë që të vlejë për rehabilitimin e të pandehurit.

Nga ana e të pandehurit dhe avokatit të tij u kerkua pafajsi për të pandehurin **A K** për veprën penale të “Përvetësimi i parave ose mallerave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale” parashikuar nga neni 287/b K.Penal

Arsyetimi i Gjykatës, argumentat juridike, interpretimi dispozitave penale, analiza e provave.

Se pari e ndodhur përpara këtyre parashtrimeve, përcaktimit të faktit dhe provave në gjykim, **Gjykata çmon se veprimet e të pandehurit A K plotësojnë të gjithë elementet që kërkon legjislacioni penal shqiptar për t'i cilësuar këto veprime si elementë të figurës së veprës penale të “Përvetësimi i parave ose mallerave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale” parashikuar nga neni 287/b K.Penal.**

Ne përmbajtjen e nenit 287/b të K.Penal, sanksionohet se:

”Kushdo që blen, merr, fsheh apo, në një mënyrë tjetër, përvetëson për vete ose një palë të tretë, apo ndihmon në blerjen, marrjen, fshehjen ose përdorimin e parave apo mallrave të tjera, duke ditur se një person tjetër ka përfituar këto para apo mallra, si pasojë e kryerjes së një vepre penale ose veprimtarie kriminale, dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në tre vjet dhe me gjobë gjer në pesëqind mijë lekë.

Paragrafi i parë i këtij neni zbatohet pavarësisht ndalimit ligjor për të marrë në përgjegjësi penale personin që ka kryer veprën penale, nga e cila rrjedh përvetësimi i parave ose i mallrave të tjera.

Objekti i veprës penale, janë veprimet e kundershmërisht të kryera nga i pandehuri **A K** të cilët kanë cenuar marrëdhëniet juridike të vendosura për të garantuar pronën të mbrojtur me Kushtetutë dhe posaçërisht nga legjislacioni penal.

Nga ana objektive vepra penale “Përvetësimi i parave ose mallerave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale” parashikuar nga neni

287/b K.Penal janë konsumuar nga i pandehuri me veprime të drejtperdrejta për realizimin e qelimit kriminal.

Nga ana subjektive, vepra penale është kryer nga i pandehuri me faj në formën e dashjes direkte, pasi i pandehuri ka parashikuar kundershmëri të veprimeve të tij dhe pasojat e vepres.

Subjekt i kryerjes së kësaj vepre penale është i pandehuri **A K** që nga hetimi gjyqësor rezultoi të jetë i përgjegjshëm për ligjin penal dhe ka mbushur moshën për përgjegjësi penale.

Referuar, analizës juridike si më sipër, Gjykata vlerëson se për shkak të bindjes së saj të krijuar mbi provat e administruara në gjykimin mbi implikueshmëri të plote të **te pandehurit A K** në veprimtarinë e kundershmëri të analizuar më sipër, në rastin konkret veprat penale për të cilat akuzohen të pandehurit janë kualifikuar drejt nga organi i akuzës sipas cilesimit të duhur juridik, të konkluduar nga konsumimi plotësisht prej të pandehurit i të gjithë elementeve të figurës së veprave penale **“Përvetësimi i parave ose mallerave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale”** parashikuar nga neni **287/b K.Penal**.

Lidhur me llojin dhe masën e dënimit që duhet të caktohet për të pandehurin **A K**, gjykata ka detyrimin ligjor të marrë në konsideratë rrezikshmëri shoqërore të vepres penale, e reflektuar në rëndësi dhe padiskutueshmëri të marrëdhënieve juridike që prekin, mënyrën dhe formën e kryerjes së vepres penale.

Gjykata bazuar në nenet 47, 48/ç,50/ç të K.Penal merr parasysh, shkallën dhe formën e fajit të të pandehurit në kryerjen e vepres penale (dashje direkte), rrezikshmëri shoqërore të të pandehurit, faktin që i pandehuri është i padënuar më parë, qëndrimin pohues e pendues të të pandehurit për veprën penale të kryer të mbajtur në hetim e gjykim, moshën e tij, gjendjen ekonomike.

Në një vlerësim të hollësishëm të përmbajtjes, konstatimeve si dhe të të gjitha rrethanave të kryerjes së vepres penale nga të pandehurit, **Gjykata konkludoi se lloji i dënimit me burgim i kërkuar nga organi i akuzës, është ligjrisht i bazuar në dispozitat përkatëse penale, e masa e dënimit me burgim e kërkuar për t’u caktuar ndaj të pandehurit nga organi i akuzës, është në raport të drejtë me vlerësimin e rrethanave të kryerjes së vepres**

penale, e ne vecanti, qendrimin e rrethanat te pranishme ne kete rast te cituara me siper.

Keshtu, lidhur me masen e denimit me burgim qe duhet te caktohet ndaj te pandehurit, ne nje vleresim te hollesishem te rrethanave te mësipërme të çeshtjes te analizuara prej saj, dhenia e mases se denimit me burgim te percaktuar nga neni **287/b** te K.Penal, cmohet nga Gjykata se do te realizoje njekohesisht jo vetem qellimin e ndeshkimit te te pandehurit per vepren penale te kryer, por edhe ate te rehabilitimit, edukimit dhe riintegrimit te pandehurit ne te ardhmen ne shoqeri.

Duke patur parasysh pasojen e ardhur, rrethanat e analizuara me lart, ne te cilat eshte kryer vepra penale gjykata çmon,qe te pandehurit ti caktoje fillimisht denimin kryesor me privim lirie.

Gjykata arrine ne perfundimin se i pandehuri A K duhet te pergjigjet penalisht per vepren penale te **“Pervetesim i parave ose mallerave qe rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale”** parashikuar nga neni **287/b K.Penal.**

Provat materiale duhet te kalojne ne favor te shtetit, pasi ato jane me vlere kulturore. Kjo bazuar ne nenin 21 te ligjit nr.9048 te vitit 2003 “Per trashgimine kulturore” nga ku rezulton se keto sende qe jane pasuri kulturore **jane prone e shtetit.**

Vepra e kryer nga i pandehuri A K paraqet rrezikshmeri shoqerore pasi ka cenuar ato marredhenie juridike te vendosura per te garantuar pronen te mbrojtur me Kushtetute dhe posacerisht nga legjislacioni penal.

Ne caktimin e mases se denimit per te pandehurin A K gjykata ka parasysh rrezikshmerine e vepres ,te pandehurit,qendrimin e tij,

PER KETO ARSYE

Gjykata bazuar ne nenin 384 te K.Pr.Penale

V E N D O S I

1. Deklarimin fajtor te te pandehurit **A K** per vepren penale te “Pervetesim i prave ose mallerave qe rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale’ “, parashikuar nga neni 287/b te K.Penal dhe denimin e tij me 1 vit e 9 muaj burgim.
2. Ne zbatim te nenit 406 te K.Pr.Penale e denon te pandehurin A K perfundimisht me 14 muaj burgim.
3. Vuajtja e denimit per te pandehurin **A K** fillon nga data 12.10.2013.
4. Denimin i pandehuri **A K** ta kryej ne nje burg te sigurise se zakonshme.

5. Ne llogaritjen e denimit te mbahet parasysh qe i pandehuri Artan Koçia nga data . deri ne date . ka qene me mase sigurimi ‘arrest ne burg’ dhe nga data . e ne vazhdim eshte me mase sigurimi ‘ arrest ne shtepi’.
6. Ne baze te nenit 190 te Kodit te Procedures Penale Kalimin ne favor te shtetit shqiptar te sendeve te sekuestrura sipas procesverbalit te sekuestrimit te proves materiale te dates . me numer rendor 1 ne 27 sekuestruar te pandehurit Artan Kociu.
7. Shpenzimet proceduriale ne hetimet paraprake si dhe ato gjyqesore ne ngarkim te te pandehurit.
8. Kunder vendimit behet ankim ne Gjykatën e Apelit per 10 dite nje dite pas shpalljes.
U shpall ne Tirane sot me dt 30.06.2014 .

SEKRETARE
BLERINA MERDANI

GJYQTAR
MARTIN DEDA